

Türkiye İş Bankası A.Ş. njofton për Shitjen e Degës në Kosovë

Türkiye İş Bankası A.Ş., një institucion financiar lider në Turqi, njofton për shitjen e aseteve dhe detyrimeve të degës së saj në Kosovë tek një institucion financiar vendas, Banka Ekonomike SH.A.

Ne shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për institucionet lokale për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm gjatë gjithë rrugëtimit të Degës sonë në Kosovë. Angazhimi dhe partneriteti i tyre i palëkundur kanë luajtur një rol vendimtar në suksesin tonë, duke nxitur një mjedis biznesi të fuqishëm dhe dinamik. Besimi dhe bashkëpunimi që kemi pasur, jo vetëm që kanë kontribuar në rritjen tonë, por kanë ndikuar gjithashtu edhe në gjendjen e përgjithshme ekonomike. Jemi vërtet mirënjohës për marrëdhëniet e mira që kemi ndërtuar dhe progresin kolektiv që kemi formësuar. Mjedisi biznesor në Kosovë vazhdon të mbetet stabil dhe i pandryshuar, por vendimi për të shitur degën është thjesht një veprim strategjik nga Bordi ynë i Drejtorëve. Ky vendim, përputhet me qëllimin tonë strategjik për të diversifikuar investimet duke qenë se po hyjmë në shekullin tonë të dytë të veprimit si bankë.

Ne gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë stafin tonë në Kosovë për profesionalizmin, përkushtimin dhe kontributin e tyre të jashtëzakonshëm gjatë këtyre viteve. Puna dhe mbështetja e tyre ka qenë shumë e rëndësishme për suksesin tonë dhe do të mbetet e tillë gjatë fazës së tranzicionit.

Klientëve tanë, ju sigurojmë se ky tranzicion po trajtohet me nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe kujdesit për të siguruar shërbim të pandërprerë dhe pa probleme. Dëshirojmë t'i sigurojmë klientët tanë se asetet e tyre do të mbeten të sigurta dhe të paprekura gjatë gjithë këtij tranzicioni. Türkiye İş Bankası A.Ş. Dega në Kosovë por edhe Banka Ekonomike SH. A. janë të përkushtuara për të ruajtur standardet më të larta të mbrojtjes së aseteve të klientëve, duke iu përmbytur të gjitha ligjeve dhe rregulloreve përkatëse për mbrojtjen e konsumatorit, në mënyrë që të mbrohen fondet dhe investimet tuaja. Për më tepër, Banka Ekonomike SH. A., si një bankë lokale me reputacion të mirë dhe stabilitet financiar, ka gatishmërinë dhe vullnetin e mirë që të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie afatgjata me të gjithë klientët tanë, gjithashtu është e përkushtuar për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për nevojat tuaja financiare. Klientët nuk kanë nevojë të ndërmarrin asnjë veprim – llogaritë, kursimet dhe kartelat e tyre do të mbeten aktive dhe të sigurta deri ne njoftim të vecantë të bankës.

Türkiye İş Bankası A.Ş., si banka lidere private në Turqi, me një themel të fortë dhe ekspertizë të gjerë mbetet plotësisht e përkushtuar për të siguruar një tranzicion të qetë gjatë gjithë procesit të shitjes. Gjatë kësaj periudhe, Dega në Kosovë do të marrë mbështetje të palëkundur financiare, mbështetje operative dhe teknike për të garantuar stabilitet dhe shërbim të pandërprerë për të gjithë klientët e saj.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni: (00 383) 38 245 245.

Shënim: Ky njoftim ka qëllim informues dhe nuk përbën një ofertë ose kërkesë.

Prishtinë, 30.07.2025

Türkiye İş Bankası A.Ş.